



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E PUNEVE TE JASHTME
Zyra e Perfaqesuesit Ligjor prane Organizmave
Nderkombetare per te Drejtat e Njeriut

Nr____.Prot

Tirane me 18.02.2002

Lenda: *Pergjigjet e Autoriteteve Shqiptare dhe masat e marra ne drejtim te permiresimit te gjendjes, pare ne kuadrin e problemeve te konstatuara ne Raportin e Komitetit per Parandalimin e Torturave dhe Trajtimeve Çnjerezore e Degraduese (CPT) per Shqiperine*

(4-14 Dhjetor 2000)

Ne lidhje me Raportin perfundimtar qe Komiteti per Parandalimin e Torturave dhe Trajtimeve Çnjerezore e Degraduese (CPT) ka hartuar per Shqiperine, pas vizites se kryer ne datat 4-14 Dhjetor 2000 dhe se fundi ne datat 22-26 Tetor 2001, Autoritetet shqiptare, te cilat jane kontrolluar nga Komiteti ne punen e tyre, me poshte paraqesin pergjigjet perkatese mbi detyrat e lena nga raporti si dhe mbi masat e marra per permiresimin e punes ne te ardhmen.

Autoritetet shqiptare gjejne rastin te shprehin konsideratat me te larta ne lidhje me kontributin e dhene nga Raporti i Komitetit per parandalimin e Tortures dhe Trajtimet Çnjerezor e Denigrues (CPT), duke shprehur dhe nje here sigurimin me te larte se ai do te sherbeje ashtu si dhe me pare per te rritur perpjekjet e kushteve te trajtimit te te paraburgosurve, te burgosurve, te semureve psiqike etj.

Ne materialin e pergatitur, pergjigjet e Autoriteteve Shqiptare jane konceptuar ne menyre kronologjike ashtu sic dhe paraqiten ne Raportin e CPT-se. Ne kete koncept kane dhene pergjigjet e tyre, duke parashtruar dhe masat e marra per permiresimin e gjendjes; Ministria e Rendit Publik, Ministria e Shendetesise, Ministria e Drejtesise, Drejtoria e Pergjithshme e Burgjeve (Tirane) dhe Ministria e Mbrojtjes.

PERGJIGJET E MINISTRISE SE RENDIT PUBLIK

- Disa kerkesa paraprake ne lidhje me nje liste ligjesh, urdherash, udhezimesh e rregulloresh qe jane fuqi dhe mbi bazen e te cilave punon policia e shtetit (pika 12).

Ne zbatim te programit te M.R.Publik, Drejtoria e Pergjithshme e Policise ka hartuar nje program pune te ndare ne tre faza qe synon hartimin dhe rishikimin e akteve normative per te plotesuar te gjitha aspektet e ligjit te Policise se Shtetit. Ne pergatitjen e ketyre akteve kane dhene ndihmesen e tyre dhe disa misione te huaja ne ndihme te policise shqiptare, si **M.A.P.E, INTERFORCA, I.C.I.T.A.P** si dhe **K.E, O.S.B.E etj**

Lista e akteve, ligjeve, rregulloreve te kerkuara vijon si me poshte:

1.Kushtetuta e Shqiperise

2.Kodi I Proçedures Penale

3.Ligji Nr.8291 dt.25.02.1998 “Kodi I etikes se policise”

4.Kodi Civil

5.Kodi I Proçedures Civile

6.Kodi Rrugor

7.Ligji Nr.8095, dt.21.03.1996 “Per sherbimin civil ne Republiken e Shqiperise”

8.Ligji Nr.8553, dt.25.11.1999 “Per policine e shtetit”

9.Ligji Nr.8775, dt.23.04.2001 “Per tubimet”

- 10.Ligji Nr.8405, dt.17.09.2000 “Per urbanistiken”
- 11.Ligji Nr.7697, dt.07.04.1993 ndryshuar me ligjin Nr 8277 dt15.02.1998 “Per kundravajtjet administrative”
- 12.Ligji Nr.8290, dt.24.02.1998 “Per perdorimin e armeve te zjarrit”
- 13.Ligji Nr.7566, dt.25.06.1992 “Per armet”
- 14.Ligji Nr.7498, dt.05.07.1991 ndryshuar me ligjin Nr.7558, date 30.01.1992 “Per ruajtjen e rendit dhe te qetesise”
- 15.Dekret Nr.1188, dt.10.08.1995 “Per policine gjyqesore”
- 16.Ligji Nr.8331, dt.21.04.1998 “Per egzekutimin e vendimeve penale”
- 17.Ligji Nr.7492, dt.08.06.1991 “Per departizimin e depolitizimin e disa organeve shteterore”
- 18.Ligji Nr.7508, dt.07.08.1991 “Per policine ushtarake”
- 19.Ligji Nr.8321, dt.02.04.1998 “Per policine e burgjeve”
- 20.Ligji Nr.8770, dt.19.04.2001 “Per sherbimin e ruajtjes dhe sigurine e objekteve”
- 21.Ligji Nr.829, dt.25.02.1998 “Per policine kriminale”
- 22.Ligji Nr.8792, dt.10.05.2001 “Per krijimin e qendres se perpunimit te te dhenave”
- 23.Ligji Nr.8750 “Per parandalimin dhe luften ndaj trafikut te substancave narkotike e psikotrope”
- 24.Ligji Nr.8342, dt.06.05.1998 “Per policine kufitare”
- 25.Ligji Nr.8432, dt.14.12.1998 “Per azilin”
- 26.Ligji Nr.8492, dt.27.05.1999 “Per te huajt”
- 27.Ligji Nr.8224, dt.15.05.1997 “Per organizimin dhe funksionimin e Policise se Bashkise dhe Komunes”
- 28.Ligji Nr.7978, dt.26.07.1995 “Per forcat e armatosura ne Republiken e Shqiperise ” me gjithe shtesen e bere ketij libri.
- 29.Ligji Nr.7496, dt.03.07.1991 “Statusi i forcave te armatosura te Republikes se Shqiperise”

- 30.Ligji Nr.7752, dt.28.09.1993 “Per Policine Ndertimore”
- 31.Ligji Nr.8388 dt, 05.08.1998 “Per grumbullimin e armeve e municioneve luftarake”
- 32.Ligji Nr.8766 dt, 05.04.2001 “Per mbrojtjen nga zjarri dhe per shpetimin”.

Vendime te Keshillit te Ministrave

1. V.K.Ministrave Nr.275 date 25.06.1992 “Per rregullat e administrimit dhe kontrollit te armeve nga personat fizik e juridik”
2. V.K.Ministrave Nr.389 date 06.08.1993 “Mbi nje shtese ne V.K.Ministrave Nr.275 date 25.06.1992”
3. V.K.Ministrave Nr.257 date 16.04.1996 “Per punen me materiale plasese dhe shperthyese”
4. V.K.Ministrave Nr.53 date 04.02.1999 “Per caktimin e zonave kufitare, llojin e armes, sasine e municionit, kriteret e dhenies se lejes per mbajtjen e armeve dhe tarifat”
5. V.K.Ministrave Nr.56 date 04.02.1999 “Per dhenien e lejes per mbajtjen e armeve nga drejtuesit dhe ortaket e shoqerive tregtare”
6. V.K.Ministrave Nr.687 date 18.10.1998 “Per shperblimin qe iu jepet shtetasve te ndryshem te cilet japin informacion per grumbullimin e armeve dhe te municioneve luftarake”
7. V.K.Ministrave Nr.204 date 22.06.1992 “Per objektet qe sigurohen me R.C te Armatosura”

Rregullore

1. Rregullore Nr.1075 date 15.09.1999 “Per sigurimin e trajtimin e te paraburgosurve”

2. Rregulore Nr.721 date 25.06.1998 “Per perdorimin e armeve te zjarrit nga Policia e Rendit dhe persona te tjere te armatosur sipas ligjit”
3. Rregulore Nr.159 date 28.09.1993 “Per sherbimet e Policise se Rendit”
4. Rregulore e Disiplines
5. Rregulore Nr.759 date 01.08.1998 “Per uniformen”
6. Rregulore Nr.171 date 26.10.1993 “E gadishmerise dhe sherbimit te informacionit ne M.R.P”
7. Rregulore Nr.110 date 19.03.1993 “Per sigurimin fizik te perfaqesive te huaja diplomatike”

Udhezime te M.R.Publik

1. Udhezimi i M.R.Publik Nr.601 date 10.12.1997 “Per kontigjentin keqberes”.
2. Udhezimi i M.R.Publik Nr.565 date 3.10.1997 “Per aktivizimin me te mire te inspektoreve te rendit ne lufte kunder krimit”.
3. Udhezimi i M.R.Publik Nr.1288 date 09.08.2000 “Per menyren e dhenies, heqjes, administrimit, dhe ruajtjes se armeve e municioneve luftarake, sportive e te gjahut te dhena me leje”.
4. Udhezimi i M.R.Publik Nr.1242 date 19.05.2000 “Per sigurimin e rendit e te qetesise gjate zhvillimit te aktiviteteve sportive kulturore fetare e veprimtarive te tjera te kesaj natyre”.
5. Udhezimi i M.R.Publik Nr.1288 date 09.08.2000 “Per kriteret e dhenies, heqjes dhe administrimit te armeve te dhena me leje”.
6. Udhezimi i M.R.Publik Nr.168 date 20.10.1993 “Per rregullat e shoqerimit te shtetasve ne Komisariate, reparte, posta te policise dhe zyra te tjera”.
7. Udhezimi i M.R.Publik Nr.933 date 10.03.1999 “Per proçedurat e grumbullimit, dorezimit, regjistrimit, dhenies dhe administrimit te armeve

te zjarrit nga drejtuesit dhe ortaket e shoqerive tregtare e banoret e zonave kufitare”.

8. Udhezimi i M.R.Publik Nr.83 date 12.01.1999 “Mbi bashkepunimin e Policise se ndertimit me Policine e Rendit”.
9. Udhezimi i M.R.Publik Nr.319 date 24.05.1995 “Per percaktimin financiar te personave juridik e fizik qe licencohen per tregtimin e armeve te gjahut”.
10. Udhezimi i perbashket i M.R.Publik me “Policine e sherbimit Pujor” Nr.1129 dhe Nr.1702 date 22.11.1999
11. Udhezimi i M.R.Publik Nr.39 date 05. 03. 1992 “Per kuptimin dhe zbatimin e disa ndryshimeve ne ligjin Nr.7498 date 05.07.1991 “Per ruajtjen e rendit dhe qetesise publike”.
12. Udhezimi i M.R.Publik Nr.260 “Per Kompletimin dhe zgjedhjen e grupeve te gateshme, te reparteve te policise se Rendit”.
13. Udhezimi i M.R.Publik Nr.1068 date 09.09.1999 “Per aplikimin e gjobave nga policia e rendit”.
14. Udhezimi i M.R.Publik Nr.1129 date 22.11.1999 “Per bashkepunimin nderdikasterial per mbrojtjen dhe zhvillimin e sektorit te pyjeve dhe kullotave”.
15. Udhezimi i M.R.Publik Nr.1 date 28.04.1998 “Per raportet dhe menyren e bashkepunimit te Prefektit dhe drejtuesve te Policise”.
16. Udhezimi i M.R.Publik Nr.1382 date 08.02.2001 “Per proceduren qe zbatohet nga Policia e Shtetit per lehtesimin e perzgjedhjen e te huajve te ndaluar”.

Urdhera te M.R.Publik

1. Urdher i M.R.Publik Nr.888 date 20.01.1999 “Mbi detyrat funksionale te strukturave te sherbimeve te rendit ne M.R.Publik”

2. Urdher i M.R.Publik Nr.674 date 21.04.1998 “Per organizimin e funksionimin e postbllloqeve te Policise”
3. Urdher i M.R.Publik Nr.2/21 date 10.03.1998 “Per zbatimin e rregullave ne marrjen ne dorezim te detyres”
4. Urdher i M.R.Publik Nr.4830 date 17.12.1992 “Per zbatimin e rregullave te sjelljes se efektivave te Policise me personalitetet e larta dhe trupin diplomatik”
5. Urdher i M.R.Publik Nr.1091 date 09.10.1999 “Mbi procedurat e dhenies se lejeve per jashte shtetit, punonjesve te strukturave te M.R.P”
6. Urdher i M.R.Publik Nr.1437/1 date 19.04.2001 “Per detyrat qe do te zbatohen para, gjate dhe pas zgjedhjeve per Kuvendin e Shqiperise”
7. Urdher i M.R.Publik Nr.783 date 31.08.1998 “Per njohjen e personelit oficer te strukturave te M.R.P, me dispozitat ligjore dhe nenligjore dhe aktet e tjera normative , kur ato emerohen ne detyre”
8. Urdher i M.R.Publik Nr.604 date 17.12.1992 “Per ndalimin e ngjarjeve te pazakonta nga perdorimi i armeve te zjarrit ne festa dhe dasma”
9. Urdher i M.R.Publik Nr.779 date 28.08.1998 “Per marrjen perpunimin dhe transmetimin e ngjarjeve te ndodhura”
10. Urdher i M.R.Publik Nr.1154 date 12.01.2000 “Per planifikimn e punes”
11. Urdher i M.R.Publik Nr.225/1 date 7.01.2001 “Per hartimin e akteve normative”.
12. Urdher i M.R.Publik Nr.591 date 03.12.1997 “Per personat ne kerkim”
13. Urdher i M.R.Publik Nr.698 date 30.05.1998 “Per kriteret qe duhet te plotesohen per tu titulluar dhe emruar oficer ne nje detyre te caktuar”
14. Urdher i M.R.Publik Nr.697 date 30.05.1998 “Per emertesat, kopetencat dhe proçedurat per titullimin, emerimin ne detyre, transferimin dhe nxjerrjen ne lirim te oficereve dhe policeve te strukturave te M.R.P”
15. Urdher i M.R.Publik Nr.1172 date 20.01.1999 “Per disa ndryshime ne urdherin e M.R.P Nr. 888, date 20.01.1999”

16. Urdher i M.R.Publik Nr.1437/1 date 19.04.2001 “Per detyrat qe do te zbatohen para, gjate dhe pas zgjedhjeve per ne Kuvendin e Shqiperise”
17. Urdher i M.R.Publik Nr.1437/2 date 19.04.2001 “Per detyrat e punonjesve te policise per sigurimin e qendres se votimit”

Projekt rregullore

1. Rregullore e brendeshme e policise se shtetit (ka perfunduar dhe eshte ne proces te miratimit)
2. Rregullore e sherbimit te grupeve te gateshme (ka perfunduar dhe eshte ne proces te miratimit)
3. Rregullore e Inspektorit te Policise se Rendit (ka perfunduar dhe eshte ne proces te miratimit)
4. Rregullore e Brendeshme e Paraburgimit (ka perfunduar dhe eshte ne proces te miratimit)
5. Rregullore e parandalimit e mbajtjes nen kontroll te territorit (ka perfunduar dhe eshte ne proces te miratimit)

Projekt urdhera

1. Urdheri “Per detyrat funksionale te strukturave te policise se rendit” (ka perfunduar dhe eshte ne proces te miratimit)
2. Urdheri “Per shoqerimin e shtetasve ne organet e policise”
3. Urdheri “Per lendet plasese dhe shperthyese” (ka perfunduar dhe eshte ne proces te miratimit)
4. Urdheri “Per organizimin e funksionimin e postbllqeve dhe te pikave te kontrollit” (ka perfunduar dhe eshte ne proces te miratimit)
5. Urdheri “Per shfuqizimin e urdherit per sherbimin e policise ne trena” (ka perfunduar dhe eshte ne proces te miratimit)

Projekt udhezime

1. Udhezimi “Per detyrat e policise gjate tubimeve” (ka perfunduar dhe eshte ne proces te miratimit)
 2. Udhezimi “Per sherbimin ne trenat e udhetareve” (ka perfunduar dhe eshte ne proces te miratimit)
 3. Per tarifat financiare te personave juridike dhe fizike qe licensohen per tregtimin e armeve te zjarrit (ka perfunduar dhe eshte ne proces te miratimit)
-

Shenim; keto jane nje pjese e akteve normative ligjore, por ka dhe shume te tjera ne vazhdim te cilat po gjykohen per tu punuar e miratuar sipas domosdoshmerise se tyre, duke respektuar fazat e caktuara per hartimin e ripunimin e tyre nga grupet e punes.

- ***Bashkepunimi me autoritetet shqiptare***

Paragrafi 12

Ne pergjigje te kesaj pike te raportit, per venien ne dispozicion te ambienteve per shoqerimin e shtetasve ne institucionet ne varesi te M.R.Publik, sqarojme se ka dhoma paraburgimi (ne te cilat sigurohen personat ne ngarkim te te cileve gjykatat jane shprehur per mase sigurimi) ne 25 Komisariate Policie. Per te zgjidhur problemet qe u ngriten ne raport, nga Drejtoria e Pergjithshme e Policise u ngrit menjehere nje grup pune I cili inspektoi ne menyre te hollesishme komisaritet e policise qe **CPT** kishte vizituar, e ne menyre te veçante Komisaritin Nr.1 ne Tirane. Me kete rast u be analiza per marrjen e masave per permiresimin e trajtimit te te paraburgosurve dhe te kushteve te qendrimit ne dhomat e paraburgimit.

□ **Tortura dhe forma te tjera keqtrajtimesh**

Paragrafi 13

Ne kete komisariat u hoqen te gjitha mjetet qe mund te sherbenin per keqtrajtim dhe torture (fuçiat me uje te ftohte). Grupi I punes trajtoi me preçedence keqtrajtimet e konstatuara ndaj te paraburgosurve ne Komisaratin Nr.1 ne Tirane. Lidhur me hetimin qe kerkohej, pengese u be refuzimi I personave te gjetur ne Komisariat per te bere denoncimin konform ligjit. Ky shqetesim u trajtua me gjithe efektivin e policise duke bere ripunimin perkates te legjislacionit vendas dhe akteve nderkombetare per te drejtat e njeriut. Nga ana tjeter u paralajmeruan dhe u moren masa te rrepta per shkelje te kesaj natyre ndaj personave pergjegjes.

Drejtori i Pergjithshem i Policise me kete rast u dergoi nje leter porosi gjithe efektivave.

Pershkrimi I rasteve konkrete

Paragrafi 14

Ne zbatim te rekomandimeve te bera nga delegacioni i **CPT**, jane hapur dhoma te egzaminimit shendetesor per te paraburgosurit, ne te gjitha Komisaritet e vendit (Perjashto Tiranen qe nuk ka dhoma te tilla dhe ky egzaminim behet ne Burgun 313).

Gjithashtu po behen perpjekje per transferimin e te gjithe te paraburgosurve, qe ligjerisht duhet te qendrojne ne burg (pavaresisht nga mungesa e burgjeve shqiptare).

□ **Masat paraprake**

Paragrafi 15

M.R.Publik ka marre masa te rrepta administrative per disa punonjes policie ne adrese te te cileve ka pasur ankesa, qofshin keta dhe punonjes te roleve te larta drejtuese, si shefa komisariatesh e Drejtores Drejtorie Qarku.

Per te respektuar nje hetim sa me objektiv, pervec veprimeve procedurale te kryera nga Prokuroria dhe Gjykata, rendesi I eshte dhene dhe relati meve te dhena nga institucioni I Avokatit te Popullit (deri dhe ne perjashtime nga policia, e punonjesve te akuzuar per shkelje te tilla).

Paragrafi 18

Jane organizuar shume aktivitete per edukimin e policise me principet demokratike te policimit dhe me te drejtat e njeriut ne bashkepunim me organizatat vendase dhe te huaja. Sidoqofte per trajnimin specifik te punonjesve qe merren drejtperdrejt me trajtimin e te shoqeruarve dhe te paraburgosurve mbetet akoma shume per te bere.

Paragrafi 20

Numerohen rreth 20 punonjes policie te ndeshkuar me masa disiplinore ne menyre te shkallezuar deri ne perjashtim nga policia dhe vendosje perpara pergjegjesise penale nga organet e drejtesise.

Rasti me I fundit qe deshmon qarte per angazhimin e vullnetit politik, eshte arrestimi (dt 25.12.2001) I Drejtorit te Drejtorise se Policise Qarkut Elbasan dhe badigardeve te tij, pas kallezimit te bere nga nje shtetas per keqtrajtim.

Paragrafi 21./3

Prokuroret apo Gjykatesit kane te drejte te parevokueshme nga asnje autoritet tjetër policor, per te monitoruar dhe mbikqyrur punen e policise gjate hetimeve penale ne çdo ambient qe ato kryhen, si dhe ne dhomat e paraburgimit (kjo e drejte eshte e sanksionuar ne Rregulloren e Sigurimit te paraburgosurve).

Paragrafi 23

Nje mase efikase per parandalimin dhe keqtrajtimin e personave te paraburgosur qe mbahen ne institucionet e administruara nga Policia e Shtetit, mendojme se do te ishte administrimi dhe trajtimi I tyre nga institucione penitenciare te specializuara te Ministrise se Drejtesise.

- ***Garantimi I te ndaluarve dhe personave te privuar nga liria kunder keqtrajtimeve***

Ne shtator te vitit 1999, M.R.Publik miratoi nje rregullore te re (1075 dt 15.09.1999) “Per trajtimin e te paraburgosurve”), e cila parashikon rregulla me humane qe kane te bejne me ajrimin e ambienteve, takimin me familjaret dhe te afermit, te drejten per te marre ushqime suplementare etj. Per hartimin e saj kemi marre parasysh dhe sugjerimet e O.J.Q-ve qe merren me te Drejttat e Njeriut, Komiteti Shqiptar I Helsinkit. Kjo rregullore eshte konsideruar e pranueshme nga misionet homologe policore te atashuara per ndihme ne vendin tone.

Paragrafi 26

Informimi I nje te afermi (neni 25 K.Pr.Penale).

Veshtiresia per te realizuar kete detyrim qendron ne rastet kur personi I shoqeruar apo ndaluar eshte me banim jashte territorit te atij Komisariati I cili kryen hetimet, dhe per me teper kur infrastruktura nuk eshte e pershtatshme per shkak te banimit ne zona te largeta.

Ne te gjitha rastet e tjera ky detyrim zbatohet.

Paragrafi 27

E drejta per te pasur nje avokat qe ne fillim te privimit te lirise.

Kjo e drejte eshte e sanksionuar me ligj, por ne shume raste neglizhohet e nenvleresohet nga punonjesit e policise qe kryejne hetime. Kjo ndodh per arsye te kushteve ekonomike te personave qe hetohen apo te pamundesise per gjetjen e avokatit nga policia brenda afatit 10 oresh.

M.R.Publik dhe D.P.Policise po punojne per te gjetur rruget dhe mjetet qe te çojne ne nje rrezultat te tille.

Paragrafi 29

Per informimin qe lidhet me te drejtat

Drejtoria Qendrore e Policise se Shtetit po ripunon Udhezimin e M.R.Publik Nr.168 dt.20.10.1993 “Per rregullat e shoqerimit te shtetasve ne komisariate, repart, posta policie e zyra te tjera”.

Shefi i Policise se Rendit dhe drejtuesit e tjere ne çdo komisarjat policie kane per detyre te afishojne ne vende te dukshme apo me flete palosje te drejtat dhe detyrimet e personave qe u eshte privuar liria.

Paragrafi 30

Kodi I sjelljes gjate marrjes ne pyetje.

Drejtoria Qendrore e Policise Kriminale ne D.P.te Policise pervec akteve te tjera te planifikuara, ka ne proces pergatitjen e nje manuali qe do te permbaje detyrimet dhe te drejtat e personave te shoqeruar apo arrestuar. Ne kete manual do te pasqyrohen; koha e shoqerimit te tij ne ambientet policore, pyetja dhe qendrimi I tij ne keto ambiente deri ne arrestimin apo lenien e lire te tij, punonjesi i policise me atributet e shoqeruesit bazuar ne kerkesat e ligjeve ne fuqi (2001-2002) etj.

Paragrafi 32

Shoqerim personash ne polici

Shoqerimi ne komisariate te tjera policore, si nje forme ndalimi me karakter administrativ per personat e tjere qe kryejne kundravajtje administrative, po zevendesohet me gjobitjen e tyre.

Sektoret e Policise kriminale po aplikojne rralle marrjen e informacionit nepermjet shoqerimit te personave ne komisariate dhe ambiente policore. Kjo pasi ne shume raste informacioni I marre ka qene I pavlefshem per shkak te frikes qe imponojne ambiente te tilla tek personat e marre ne pyetje, e per rrjedhoje keto informacione kundershohen nga organet e prokurorise apo gjykata. Egziston nje psikologji e individeve shqiptare lidhur me ambientet policore, qe I ben t`I shmangen dhenies se informacioneve te sakta per shkak te frikes se cilesimit spiun nga opinioni qe I rrethon.

Keto forma po zevendesohen me metoda te tjera te percaktuara ne aktet normative me te cilat punon sektori I policise kriminale.

Edhe ne rastet kur dyshohet se personi I shoqeruar mund te jete autor I mundshem I nje vepre penale, shoqerimi I tij ne ambientet e komisariateve nuk zgjat me shume se 10 ore. Me pas ata ndalohen apo arrestohen ne

flagrance (kur I provohet pafajesia) ose lihen te lire. Gjykata eshte ajo qe vendos perfundimisht per izolimin apo jo te personit.

- **Kushtet e ndalimit dhe paraburgimit, dhomat e ndalimit.**

Paragrafi 34, 35, 37, 38

M.R.Publik dhe Drejtoria e Pergjithshme e Policise ka siguruar fonde per rikonstruktimin e te gjitha komisariateve qe kane dhoma paraburgimi, kryesisht ne drejtim te kushteve higjenosanitare, te ambienteve te takimit me familjaret, dhomave frigoferike per rezervat ushqimore, paisjen me shtroje e mbulesa dhe kushteve te tjera humanitare.

Persa I perket kubaturave dhe ajrimit jo te pershtatshem (qe eshte konsideruar si nje forme torture), sqarojme se pothuaj te gjithe ambientet e paraburgimit ne komisariatet e policise ne shkalle vendi jane ndertuar perpara viteve 1980. Si te tilla ato mund te riparohen vetem ne drejtim te mirembajtjes, por nuk mund te nderhyhet ne zgjerimin e kubaturave e hapësirave sepse ne shume raste jane ne themele te ndertesave te Komisariateve te Drejtorive, ose nuk e lejojne kushtet teknike te ndertimit nje gje te tille.

Ky shpenzim edhe ne rast se do te parashikohej, do te shkonte dem pasi ne te ardhmen e afert sistemi I paraburgimit deri tani ne varesi te M.R.Publik do te kaloje teresisht ne varesi te Ministrise se Drejtesise.

Paragrafi 36, 39.

Lokalet e policise te destinuara per paraburgim.

Mbajtja e te paraburgsurve per shume muaj ne ambiente qe nuk plotesojne kushte.

Pas dhenies se mases sigurimit nga gjykata, shume te paraburgosur, (sidomos ne Tirane), per arsye te ndryshme (nuk I pranon burgu 313 se nuk ka vend), qendrojne ne menyre te jashteligjshme dhe jashte çdo kushti njerezor ne ambientet e shoqerimit te komisariateve. Qendrimi per me shume se 10 ore ne keto ambinete veshtireson jeten e personave qe u privohet liria ne drejtim te se drejtes per ushqim, e cila nuk mund te sigurohet nga Komisariati per arsye te ndryshme.

Paragrafi 40

Ndarja e minoreneve dhe grave nga te paraburgosurit e tjere.

Per zgjidhjen e ketij problemi eshte bere nje marreveshje me Drejtorine e Pergjithshme te Burgjeve qe kjo kategori te paraburgosurish, te transferohen menjehere ne Burgun 313 Tirane, pavaresisht nga faza e hetimit apo gjykimit te tyre. Ne shume raste kjo marreveshje nuk respektohet nga D.P.Burgjeve dhe si pasoje e pamundesise se sistemimit te te miturve ne dhoma te veçanta, ata bashkohen me te tjeret. Sistemimi per te paraburgosurit femra eshte me pak i veshtire, por haset shume veshtiresi ne trajtimin e tyre, pasi ne policine shqiptare nuk sherbejne punonjese te policise femra ne keto sektore.

Paragrafi 44

Kontaktet e reduktuara me te afermit.

Ne rregulloren Nr.1075 dt 15.09.1999 “Per sigurimin dhe trajtimin e te paraburgosurve” eshte sanksionuar qe takimi I te paraburgosurve me te afermit e familjaret te behet 3 here ne muaj ne nje kohe prej ½ e ores.

Eshte e vertete qe kjo kohe ne disa raste reduktohet nga punonjesit e sherbimit, por shkelja e kesaj te drejte vjen si pasoje e mbingarkeses (me

shume se dyfishi I kapacitetit te mbajtjes) dhe mbi popullimit si dhe numrit te paket te punonjesve te policise qe sherbejne ne kete detyre.

- ***Personat e ndaluar ne kuadrin e legjislacionit per te huajt.***

Paragrafi 47

Per sa I perket konstatimeve ne aeroportin e Rinasit sqarojme se nga ana e M.R.Publik sherbimi ne keto aeroporte eshte pare si I nje rendesie te vecante dhe per kete arsye jane marre disa masa per meremetimin dhe rikonstruktimin e ambienteve policore te atashuara ne kete objekt. Ne lidhje me zbatimin e kerkesave te Ligjit “Per te huajt” dhe “ Per Azilin” kohet e fundit nga Drejtoria Qendrore e Policise Kufitare jane organizuar disa takime e seminare me shefat e Policise Kufitare ne rrethe, per ti qartësuar ne lidhje me zbatimin e tyre. Nje pjese e mire e efektivave te ketij sherbimi po kualifikohen e trajnohen ne kurse brenda e jashte vendit.

Kerkesa per paisjen e ambienteve te tranzitit me qellim qe personat e ndaluar ne kete vend te kene te drejten e perdorimit te telefonit publik me karte, mendojme se duhet te zgjidhet nga Ministria apo Drejtoria qe ka ne juridiksion sherbimin e transportit ajror.

E drejta e personave per informim dhe komunikim normal ne gjuhet e tyre, eshte zgjidhur duke emeruar ne keto vende punonjes policie qe zoterojne disa gjuhe te huaja e sidomos ate angleze.

Paragrafi 48

Mbajtja e azilkerkuesve

Kerkesat e Ligjit “Per azilin” nuk jane vlerësuar dhe respektuar sepse kerkesat e bera per te perfiturat kete status (azilant) nga personat e huaj ne vendin tone, jane shume te rralla dhe nuk njihen nga praktika e vendit tone.

Infrastruktura per ambientet e trajtimit te tyre ne qendra te veçanta ka lindur si domosdoshmeri kohet e fundit. Problemi per ngritjen e qendrave te azil kerkuesve dhe atyre te tranzitit i eshte bere prezent qeverise per marrjen e masave te duhura me kete rast.

Ne zgjidhje te problemeve qe kane te bejne me parandalimin e keqtrajtimeve dhe torturave nga punonjesit e policise ndaj shtetasve, eshte vendosja e nje numri telefoni civil ne Ministrine e Rendit publik. Kjo i jep mundesi te gjithe personave qe kane probleme te tilla, te ankohen me kete numer telefoni pa qene nevoja te japin identitetin e tyre.

Nga ky aplikim per muajin shtator 2001 jane marre 68 ankesa. Pas verifikimit te tyre nga strukturat perkatese, jane marre masa disiplinore te ndryshme deri ne perjashtim nga policia e shtetit per 8 punonjes policie te niveleve te ndryshme.

Ne M.R.Publik, ka edhe struktura si Sherbimi I Kontrollit te Brendshem, Inspektimi I Pergjithshem I Ministrit, qe kane objekt pune midis te tjerave ankesat e qytetareve.

PERGJIGJET E DREJTORISE SE PERGJITHSHME TE BURGJEVE

Gjate vizites qe delegacioni i **CPT** beri ne dhjetor 2000, vizitoi dy institucione ne varesi te Drejtorise se Pergjithshme te Burgjeve dhe me konkretisht;

Burgun e Burrelit dhe Spitalin e Burgjeve –Tirane.

Duke vleresuar sugjerimet dhe rekomandimet e bera nga **CPT**, po japim disa pergjigje ne lidhje me masat qe jane marre ne kuadrin e reformimit te Sistemit Shqiptar te Burgjeve.

Paragrafi 56

Lidhur me plotesimin e kuadrit ligjor, jane miratuar nje sere dispozitash te reja e me konkretisht; eshte miratuar Rregullorja e Pergjithshme e Burgjeve si dhe rregulloret e veçanta te çdo institucioni te vuajtjes se denimit, sipas shkalles se sigurise. Nen driten e rekomandimeve te **CPT**, autoritetet shqiptare jane te angazhuara teresisht per aplikimin e tyre rigoroz ne praktike.

Paragrafi 57

Persa i takon programit te zgjerimit dhe ndertimit te burgjeve te reja, per te frenuar problemin e mprehte te mbipopullimit me te cilin perballemi, eshte bere nje progres i rendesishem. Keshtu ka perfunduar rikonstruksioni i katit te trete te Burgut 302, ne Tirane me 80 vende shtese. Ka perfunduar ndertimi i plote i Burgut te ri te Rrogozhines si dhe i Institutit te Shendetit Mendor ne Kruje.

Jane duke u ndertuar: Burgu i Peqinit, me nje fond prej 6.000.000 USD, kapacitet 350 vende qe do te perfundoje ne gusht 2002; Burgu i Lezhes, me financim te Komunitetit European, me nje fond te sapoçelur prej 640.000 Euro. Ky Burg ka kapacitet 750 vende dhe mendohet te perfundoje brenda 6 muajve, Burgu i Fushe-Krujes me kapacitet 330 vende. Projekti ka perfunduar dhe per te pritet financimi nga Komuniteti European dhe oponenca e tyre. Eshte parashikuar qe ky te jete nje burg i sigurise se zakonshme.

Mendojme se ngritja e burgjeve te reja do te zbuse problemin e mbipopullimit ne Sistemin Shqiptar te Burgjeve.

Paragrafi 58

Problemi i mungeses se punesimit eshte teper i mprehte.. Verejtja e konstatuar nga CPT eshte e drejte dhe mungesa e vendeve te punes per te denuarit tane ka ardhur si pasoje e sensibilizimit te pamjaftueshem te shoqatave, firmave te ndryshme prodhuese. Lidhur me punesimin aktual, permenden inisiativa te veçanta, sporadike te shoqatave te ndryshme, por gjithsesi problem mbetet siperfaqja territoriale e pamjaftueshme e burgjeve tona (duke perjashtuar Burgun e Lushnjes, siperfaqja e burgjeve te tjera eshte e vogel dhe nuk mundeson organizimin e workshopeve brenda ketyre territoreve). Baza ligjore per zgjidhjen e ketij problemi ka shume mangesi dhe kerkon pune per t`u zbatuar.

Theksojme se Burgu i ri i Peqinit dhe Fushe –Krujes jane projektuar per te pasur hapësira per punesimin e te denuarve brenda territorit te institucionit. Brenda hapësires ligjore, eshte aplikuar edhe puna vullnetare e te denuarve per sherbimet e brendshme, jo per qellime perfitimi por duke gjykuar qe ne kete menyre do te behet e mundur krijimi i kushteve komode per ta dhe per ambientin ku jetojne.

Per te paraburgosurit do te behen perpjekje qe te krijohen kushte te pershtatshme per punesim.

Paragrafi 59

Per te denuarit me denim me vdekje, denim I cili eshte kthyer ne burgim te perjetshem, i nenshtrohen nje regjimi te ri te parashikuar ne dispozitat ligjore perkatese. Trajtimi i tyre behet I njejte me te denuarit e tjere me burgim;

kufizimet e tjera qe lidhen me trajtimin e kesaj kategorie jane hequr qe nga 1997, pas rekomandimeve te **C.P.T** ne ate vizite.

□ **VIZITA NE BURGUN E BURRELIT**

2.Keqtrajtimet

Per shkak te mungeses se Rregullores se Policise se Burgjeve si dhe rregulloreve te veçanta te çdo burgu, ka pasur raste te komunikimit ne forma joetike nga ana e personelit te policise me te denuarit, qe ka çuar deri ne konflikte ne te shara apo perdorim te pamotivuar te forces.

Lidhur me verejtjet e bera nga **CPT**, Drejtoria e Pergjithshme e Burgjeve, bazuar ne eksperiencen Europiane, po heq nga struktura te ashtuquajturat “Grupe te Ngjashme” duke parashikuar krijimin e nje grupi te vetem emergjence, i cili te nderhyje vetem ne raste teper ekstreme si: revolta etj. Sipas kesaj praktike te re qe do te futet ne burgje nuk do te kete me grupe emergjente te perbera prej nje numri te reduktuar personash, per te ndihmuar ne mbarevajtjen e aktivitetit 24 oresh.

Me dergimin e Qarkores se Drejtorise se Pergjithshme te Burgjeve, qe nga periudha e konstatimit te rasteve te keqtrajtimet, ka pasur reflektim pozitiv. Detyrat funksionale te stafit te policise jane percaktuar tashme ne menyre te detajuar ne Rregulloren e Policise se Burgjeve.

Zgjidhja e incidenteve te ndryshme behet konform rregullave. Perdorimi i forces behet vetem ne raste ekstreme, kur cenohet jeta e stafit te policise dhe gjithmone ne perputhje me dispozitat ligjore e nenligjore ne fuqi. Kjo risi ka ardhur si rezultat i trajnimit te te gjithë stafit te nivelit baze ne Qendren e trajnimit te burgjeve. Ideja e programeve si nje mentalitet i ri i punes ne burg ka sherbyer per nje komunikim me te mire dhe respektimin e te drejtave te te denuarve.

Paragrafi 64

Persa i perket mbajtjes se shkopit te gomes ne menyre te dukshme, ky eshte nje problem qe do te perpiqemi ta evitojme sa me shume te jete e mundur.

Paragrafi 65

Ne kuadrin e verejtjeve te bera per kete pike, eshte pergatitur nje Urdher per Ministrine e Drejtesise per te bere kategorizimin e sigurise ne dy shkalle; siguri e larte dhe siguri e zakonshme. Te denuarit me masa relativisht te ulta denimi do te akomodohen ne seksionet e sigurise se zakonshme duke iu referuar Ligjit "Per te drejtat dhe trajtimin e te denuarve" si dhe per te mundesuar afersine me familjet.

Paragrafi 66

Po punohet per pergatitjen e ambienteve te pershtatshme sipas nenit 21 te Rregullores se Pergjithshme te Burgjeve. Njekohesisht, me venien ne funksionim te burgjeve te tjere, do te zbatohen te gjithë parametrat e parashikuara (me 4m² e 9m² per çdo te denuar). Po ashtu ka filluar mobilimi i dhomave me sendet e nevojshme si: tavoline, karrige plastike etj.

Gjithashtu po punohet per sigurimin e ngrohjes per te denuarit. Eshte menduar qe ky problem te zgjidhet me sistemin e ngrohjes qendrore, qe do te realizohet me buxhetin e vitit 2002.

Paragrafi 67

Jane akorduar 5 milione leke per rregullimin e kushteve persa i perket parregullsive te verejtura ne sektorin C. Detergjentet u shperndahen rregullisht te denuarve sipas normave ne fuqi.

Problemi i furnizimit me uje eshte zgjidhur. Po ashtu dhe problemi i dushit nje here ne jave.

Tani rrobat kane filluar te lahen ne lavanteri dhe per larjen e tyre eshte shtuar nje ore ajrim.

Paragrafi 68

Drejtoria e Burgut Burrel ka kerkuar nga Drejtoria e Pergjithshme, fond per paisjen me soba, dhome frigoferike etj. Drejtoria e Pergjithshme eshte angazhuar t`i perfshije keto fonde ne buxhetin e vitit 2002.

Rritja e normes se ushqimit, ne bashkepunim me Ministrine e Shendetesise do te jete nje hap pozitiv persa i perket permiresimit te ushqimit.

Paragrafi 70-73

Eshte e vertete qe angazhimi me pune apo aktivitete te tjera ne Burgun e Burrelit eshte i paket. Ne kuadrin e rekomandimeve te **CPT**, jane marre masa nga Drejtoria e Burgut per ndertimin e nje kendi sportiv. Po ashtu jane shtuar disa aktivitete sportive si; basketboll etj. Eshte rritur koha e qendrimit ne sheshin e ajrimit nje ore me teper dhe 5 ore per te denuarit e semure, bazuar ne rekomandimin e mjekut.

□ SHERBIMI MJEKESOR

Sherbimi mjekesor ka filluar te permiresohet vazhdimisht. Te gjitha te ardhurit e rinj i nenshtrohen kontrollit mjekesor per te evituar problemet e ndryshme shendetesore per te denuarit e tjere. Po ashtu konsultat mjekesore behen te rregullta.

Ngrohja e ambienteve mjekesore eshte menduar te marre zgjidhje ne kuadrin e sigurimit te ngrohjes se pergjithshme te ketij burgu (parg 66).

Njoftojme **CPT**-ne se ne kete burg nuk ka me medikamente te skaduara dhe per te denuarit qe kane nevojte, marrja e ilaceve behet sipas rekomandimeve te mjekut.

Paragrafi 81-82

Drejtoria e Pergjithshme e Burgjeve i konsideron esenciale marredheniet e mira midis personelit dhe te denuarve per te evituar çdo forme negative te komunikimit mes tyre. Nje pune e mire ne kete drejtim eshte bere ne nivelin baze ne ***Qendren e Trajnimit te Burgjeve*** per trajnimin e stafit, ku nje rendesi e veçante I jepet rolit te edukatoreve.

Paragrafi 83-84

Te denuarit e vendosur ne izolim kane te drejte te perfitojne nje ore ajrim ne dite. Po ashtu procedura disiplinore po zhvillohet ne perputhje me dispozitat e parashikuara ne Ligjin “Per te drejtat dhe trajtimin e te denuarve”, ku çdo gje pasqyrohet ne nje rregjister te posaçem.

Masa po merren per rregullimin e dhomave te izolimit me paisje te fiksuara.

Paragrafi 87

Lidhur me verejtjet e **CPT-se** persa i perket kontakteve me boten e jashtme informojme se:

- -ambientet e takimeve me familjaret jane permiresuar;
- -I eshte dhene perparesi atyre te denuarve, familjaret e te cileve vijne nga zona te largeta;

- -Eshte parashikuar instalimi i telefonave me karte ne ambientet e ketij institucioni, gje qe do te lehtesonte kontaktet me jashte.

□ **VIZITA NE SPITALIN E BURGJEVE TIRANE**

Informojme se rikonstruksioni ne te dyja pavionet (infiktivi dhe kirurgjia) ka mbaruar, duke zgjidhur problemet mbi sistemin e ngrohjes dhe instalimet sanitare.

Aktualisht ne pavionin e psikiatrie jane akomoduar 36 paciente dhe totali i te shtuarve eshte 80, çfare do te thote qe nuk ka asnje person mbi kapacitet.

Struktura e ketij institucioni tani eshte; Drejtor, Zv/Drejtor dhe stafi mjekesor i perbere nga: shefi i klinikes, mjek kardiolog, mjek infeksionist, kirurg, infermiere dhe sanitare. Ne total stafi civil numeron 46 persona ndersa ai i policise se burgjeve 82 persona (totali 128)

Paragrafi 90

Posti vakant i farmacistit eshte plotesuar dhe po behet kujdes qe te mos perdoren ilaçe te skaduara apo te papershtatshme.

Problemi i ngrohjes eshte zgjidhur pas rinovimit te spitalit. Aktualisht ngrohja sigurohet nga Rrjeti i Qendres Spitalore Universitare ne Tirane dhe salla e mjekimeve tani eshte ne gjendje te mire.

Ne fundjave, aktualisht mjeket punojne 5 ore te shtunave ndersa personeli infermier eshte i pranishem gjate gjithe kohes.

Punonjesi social aktualisht mungon por eshte planifikuar te futet me organikat e reja per vitin 2002. Ky punonjes i specializuar do te beje te mundur ofrimin e formave te ndryshme te aktiviteteve psiko-sociale.

□ **KUSHTET E JETESES SE PACIENTEVE**

Dhomat e pacienteve mbahen te pastra dhe kane paisjet e nevojshme si: shtrat, çarçafe, dysheke, batanije, stola etj. Siç u permend me lart, problemi i ngrohjes eshte zgjidhur.

Eshte permiresuar gjendja e tualeteve si dhe aksesoreve te tjere higjienike dhe eshte vene ne funksionim lavaneria.

Ushqimi eshte permiresuar dhe pritet miratimi i normes se re ushqimore qe do te permiresoje normen egzistuese.

Ajrimi ne ajer te paster eshte problem, por eshte menduar te zgjidhet nepermjet ngritjes se nje sheshi ajrimi per pacientet qe e kane te mundur daljen ne ajer te paster.

Po ashtu siç kemi informuar me siper, ne Pavionin e Psikiatrie nuk ka me mbipopulim dhe eshte evituar qendrimi i pajustificuar i pacienteve per kohe shume te gjata.

□ **TRAJTIMI I PACIENTEVE**

Per te garantuar nje trajtim sa me te mire te pacienteve eshte shtuar bashkepunimi me mjeket e Qendres Spitalore Universitare per probleme te ndryshme mjekesore.

Pacienteve te ardhur u behet egzaminimi mjekesor profesional. Rrezultatet e konstatuara u komunikohen vete pacienteve apo perfaqesuesve te tyre. Ne rastet kur verehen demtime gjate egzaminimit, kjo evidentohet dhe behet njoftimi I prokurorit per çdo demtim te konstatuar duke bere dhe

dokumentimin perkates (pavaresisht se egziston si praktike, deri tani nuk ka pasur raste te tilla te evidentuara).

Programet e ndryshme te trajtimit terapeutik, mbeten ende problem per spitalin e burgjeve pasi nuk aplikohen programe te vecanta trajtimi si: ergo-terapi, terapi grupi etj apo programe te tjera te tipit rehabilitues. Drejtoria e Pergjithshme e Burgjeve po perpiqet per korigjimin e mangesive te evidentuara. Ne kuadrin e ndryshimeve per vitin 2002, me futjen e punonjesit social do te behet i mundur nje permiresim I dukshem ne kete drejtim.

Kategoria e te semureve mendore te deklaruar nga gjykata si te papergjegjshem, akomodohen ende ne Spitalin e Burgjeve. Me perfundimin e Institutit te Shendetit Mendor dhe futjen ne funksionim te tij, do te kete zgjidhje dhe per kete kategori personash. Akomodimi i tyre do te behet se shpejti ne mjedise te caktuara ne Institutin e Shendetit Mendor ne Kruje.

□ ÇESHTJE TE TJERA NE LIDHJE ME MANDATIN E CPT

Paragrafi 97

Kontaktet e pacienteve me te afermit e tyre realizohen ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi. Konkretisht te denuarit kane te drejten e 4 takimeve ne muaj me kohezgjatje nga 30 minuta deri ne 1 ore.

Ndersa te arrestuarit e tjere kane te drejten e 2 takimeve ne muaj me te njeten kohezgjatje (30 min-1 ore).

Gjithashtu salla e pritjes eshte rregulluar dhe jane vendosur karrige per te realizuar takimet me familjaret apo vizitore te tjere.

Paragrafi 98-99

Mjetet shtrenguese ndaj pacienteve te dhunshem veçanerisht atyre me probleme mendore, jane perdorur ne raste ekstreme si nje mjet i fundit per te parandaluar agresivitetin e tyre. Perdorimi i mjeteve shtrenguese behet me urdher te mjekut dhe heqja e tyre behet sapo pacienti qetesohet dhe nuk manifeston shenja agresiviteti. Raste te tilla dokumentohen nga personeli pergjegjes.

Paragrafi 101

Njohja e pacienteve me rregulloren e institucionit dhe te drejtat e tyre u behet menjehere sapo ato pranohen ne Spitalin e Burgjeve. Verejtja e **CPT** per ti permbledhur keto te drejta ne nje broshure eshte me vend. Drejtoria e institucionit po merret me pergatitjen e nje broshure te tille per t`ia dhene te gjithë pacienteve qe shtrohen.

Drejtoria e pergjithshme e Burgjeve, pasi eshte njohur me materialin e derguar nga **CPT**, e ka analizuar ate dhe ne kuadrin e rekomandimeve te bera ka mare masa per te permiresuar gjendjen atje ku nevojat kane qene me imediate. Po ashtu institucionet qe kane qene objekt i vizites se fundit te **CPT** jane njohur me raportin dhe mbi bazen e urdherave te nxjerra nga Drejtoria e Pergjithshme, kane nxjerre urdhera te brendshem per permiresimin e situates.

Drejtoria e Pergjithshme i vlereson sugjerimet tuaja si teper pozitive dhe mendon se ato sherbejne per thellimin e reformes qe po ndermerret per

permiresimin e Sistemit Shqiptar te Burgjeve dhe per procesin qe kemi perpara: ate te kalimit te paraburgimit ne varesine tone.

VIZITA E C.P.T NE TETOR 2001

Gjate vizites se tij ne tetor, delegacioni i C.P.T vizitoi Burgun 313 dhe spitalin e Burgut. Per sa i perket rekomandimeve te bera nga delegacioni per mbarevajtjen e burgut informojme si me poshte vijon:

Administrata e Burgut 313 ka ndermarre masa te nevojshme per nje egzaminim paraprak te personave te ndaluar, menjehere sapo ato futen ne kete institucion. Egzaminim i metejshem behet ne spitalin e Burgut. Administrata e Burgut ka pergatitur nje regjister baze per te dhenat mjekesore te vecanta, ku te pasqyrohen te gjitha rastet e demtimeve te evidentuara nga doktori. Te gjitha demtimet e evidentuara paraqiten ne kete regjister, ne baze te te cilit doktori pregatit nje raport konfidencial per Drejtorin e Burgut per kete qellim.

Rastet e personave me probleme droge, qe futen ne Burgun 313, rregjistrohen gjithmone.

Drejtoria e Pergjithshme e Administrates se Burgut gjithmone ka analizuar dhe vleresuar raportin e hartuar nga delegacioni i C.P.T dhe ne kuadrin e rekomandimeve te bera ka marre masat e nevojshme per te permiresuar situaten sa me shume te jete e mundur. Rekomandimet e C.P.T u jane bere te njohura institucioneve te vizituara nga delegacioni i C.P.T. Keshtu bazuar ne urdherat e trajtuara nga Drejtori i Pergjithshem, çdo Drejtor Burgu trajton urdherat e brendshme respektive per te permiresuar situaten.

Drejtoria e Pergjithshme e Administrates se Burgut i konsideron sugjerimet e C.P.T si teper konstruktive dhe pozitive. Ajo eshte e mendimit qe keto sugjerime do te ndihmojne ne thellimin e reformes qe kemi ndermarre per permiresimin e situates ne Sistemin Shqiptar te Burgjeve dhe per zgjidhjen e problemit me delikat qe do te perballemi ne te ardhmen: Kalimi i sistemit te paraburgimit nen administrimin tone.

PERGJIGJET E MINISTRISE SE SHENDETESISE

Ministria e Shendetesise ne vijim te raportit te paraqitur mbi viziten e kryer ne Shqiperi nga Komiteti Europian per Parandalimin e Torturave dhe Trajtimit çnjerezor, gjate periudhes 4-14 dhjetor 2000, informon mbi masat e marra per permiresimin e gjendjes ne zbatim te detyrave te percaktuara nga ky raport.

Paragrafi 103

Mbipopullimi dhe kapacitetet e medha ne shtreter te institucioneve qe trajtojne persona te prekur me afeksione psikiatrike.

Lidhur me problemin e mbipopullimit dhe numrit te madh te shtreterve ne institucionet psikiatrike, ne Ministrine e Shendetesise eshte ngritur dhe funksionon Komiteti Drejtues I Shendetit Mendor. Ky Komitet ka ne perberje perfaqesues te institucioneve te lidhura me problemet e shendetit mendor (perfaqesues te Ministrise se Shendetesise, Ministrise Arsimit, Ministrise Punes dhe Çeshtjeve Sociale, psikologe, perfaqesues te Qendrave

te shendetit mendor, Klinikes Psikiatrike Universitare, eksperte te OBSH ne fushen e shendetit mendor).

Komiteti Drejtues I Shendetit Mendor po merret me pergatitjen e strategjise dhe planit te veprimit ne fushen e shendetit mendor ne Shqiperi. Kjo strategji synon ngritjen e rrjetit te sherbimeve komunitare per personat me probleme te shendetit mendor dhe trajtimin e pacienteve me skuadra multidisciplinare duke perfshire ne strukturat e instituconeve tona shendetesore dhe punonjes sociale e psikologe. Realizimi I nje strategjie te tille do te siguroje njohurite bashkekohore dhe trajtimin e duhur per personat qe kane nevojte per mbeshtetje ne perballimin e semundjeve mendore. Kjo ben te mundur uljen e stigmes per keta paciente dhe integrimin e tyre ne jeten familjare e sociale. Kjo çon ne rritjen e kujdesit ndaj pacienteve ne qendren ku ata banojne dhe ne menyre indirekte ne uljen e numrit te pacienteve qe strehohen ne institucionet psikiatrike me shtreter. Per t`i dhene shtytje kesaj ideje, Ministria e Shendetesise ne bashkepunim me OBSH gjate muajit dhjetor 2001, organizoi nje takim me perfaqesues te organizatave dhe organizmave joqeveritare qe operojne ne Shqiperi. Ky takim sherbeu per te stimuluar akoma me shume permiresimin e shendetit mendor dhe integrimin e pacienteve ne komunitet.

Paragrafi108

Mbi trajtimin e keq fizik ne spitalet psikiatrike Vlore dhe Shkoder

Lidhur me problemin e keqtrajtimeve ne spitalet psikiatrike, jane zhvilluar bisedime me personelin shendetesor ne spitalet psikiatrike te Vlores dhe Shkodres. Keto takime (veçanerisht me personelin ndihmes) kane pasur per qellim sensibilizimin me etiketen mjekesore, kodin e pacientit dhe implementimin e ligjit per shendetin mendor, duke vene ne plan te pare te

drejtat e pacientit. Drejtuesit e institucionit po pergatisin nje rregullore mbi rastet e perdorimit te masave shtrenguese.

Paragrafi 114/1

Çdo pacient te disponoje nje shtrat dhe mbulesat e nevojshme, te pastruara ne intervale te pershtatshme.

Me fondet e dhena nga Ministria e Shendetesise eshte bere blerja e materialeve per paisjen e pacienteve me krevat, complete çarçafesh, kellefe jasteku e mbulesa te reja. Nje here ne 2 muaj behet higjenizim dhe dizinfektim i te gjithë pavioneve, i rrobave te te semureve, duke permiresuar disi kushtet e jeteses se pacienteve. Gjate vitit 2002 me fondet e Ministrise se Shendetesise do te merren masa per plotesimin e te gjitha nevojave te pacienteve.

Paragrafi 114/2

Çdo pacient te marre ushqim te kenaqshem ne planin sasior, cilesor dhe te behet peshimi I rregullt I tyre.

Lidhur me permiresimin sasior dhe cilesor te ushqimit qe marrin te semuret, jane marre masa per permiresimin e llojshmerise se dietes, per mbulimin e kalorazhit ditor dhe cilesine e gatimit. Çdo 2 muaj behet peshimi I pacienteve te shtruar ne spitalet perkatese. Gjithashtu po behen perpjekje per paisjen e ambienteve me tavolina e karrige, ne menyre qe dhe pacientet e degraduar te ushqehen ne kushte njerezore.

Paragrafi 114/3

Çdo pacient (veçanerisht ato pa te ardhura) t`u shpermdahen kepuce, veshje, dhe te brendeshme te pastra ne gjendje te mire dhe sipas sezonit.

Drejtoria e Spitaleve ka marre masa per sigurimin me veshje te trasha per dimer dhe veshje te lehta per vere te pacienteve. Gjithashtu per çdo te semure jane siguruar rezerva per veshje te brendeshme. Problem mbetet larja e tyre e rregullt si rrjedhoje e mosfunksionimit normal te lavanterise per shkak te mungeses se energjise elektrike. Gjithashtu po behen perpjekje qe te sigurohet per çdo pacient nje dollap individual per vendosjen e rrobave personale.

Paragrafi 114/4

Venia ne dispozicion e materialeve adaptuese karrike me rrota)

Per pacientet polihandikap ka filluar perdorimi I karrikeve me rrota, ne menyre jo te vazhdueshme. Kjo per shkak se duhet kohe qe perdorimi I tyre te behet nje rregull i zakonshem per personalin. Jane bere takime me karakter keshillues per personelin e mesem mjekesor, qe te kuptohet nevoja e perdorimit te materialeve adaptuese qe krijojne komfort jetese per keto paciente.

Paragrafi 114/5

Çdo pacient duhet te marre artikujt e higjienes personale baze dhe te beje dush te pakten nje here ne jave.

Paisja me artikuj te higjienes personale megjithe ndonje permiresim te paket, mbetet angazhim per t`u realizuar nga Drejtoria e spitaleve perkatese. Kane

filluar te permiresohen kushtet e larjes se pacienteve (berja dush nje here ne jave si dhe shperndarja here pas here e materialeve per perdorim vetjak).

Paragrafi 114/6

8.Pacientet te kene nje mjedis intim personal, veçanerisht nje dollap me çeles

Per kete problem jane marre masa per paisjen e nje pjese te pacienteve te shtruar me dollape personale, ku mund te vendosin sendet e tyre vetiake. Po behen perpjekje qe te kompletohen te gjitha dhomat me dollape personale te mbyllur me çeles.

Paragrafi 114/7

Te garantohet furnizimi me energji elektrike ne çdo kohe.

Energjia elektrike mbulon vetem ndriçimin, por jo ngrohjen dhe paisjet qe punojne me energji elektrike. Mungesa e energjise elektrike vazhdon te jete problem duke krijuar veshtiresi ne krijimin e kushteve te pershtatshme per pacientet e spitalit. Ne bashkepunim me Korporaten Elektrike po behen perpjekje qe institucionet shendetesore te kene prioritet ne furnizimin me energji elektrike nepermjet venies ne perdorim te linjave direkte. Aktualisht furnizimi me energji elektrike eshte permiresuar mjaft, gje e cila ka çuar ne krijimin e nje mejdisi me te paster dhe te nje jete me komforte per pacientet.

Paragrafi 114/8

Te vendoset sistemi I ndriçimit ne raste urgjente ne pavione te ndryshme.

Per sistemin e ndriçimit ne rastet urgjente, perveç gjeneratorit i cili siguron ndriçimin e nevojshem gjate mungeses se dritave, jane vene ne perdorim edhe disa llampa halogjene te cilat ndriçojne dhomat, derisa te vihët ne pune gjeneratori.

Paragrafi 114/9

Rregullimi I ambienteve ku qendrojnë pacientet dhe riparimi I xhamave te thyer.

Per permiresimin e kushteve te jeteses jane bere riparime te mureve te dhomave, per eleminimin e lageshtires si dhe jane marre masa per riparimin e dyerve, dritareve dhe zevendesimin e xhamave te thyer.

Paragrafi 114/10

Ambientet dhe paisjet e guzhines te jene ne gjendje pune.

Jane marre masa per paisjen e guzhines me te gjitha materialet e nevojshme si; luge, tenxhere, kosha per mbeturinat, karrike dhe tavolina, atje ku keto mungojne. Furnizimi me materialet e nevojshme per pastrim dhe rritja e kontrolleve ne keto ambiente nga ana e Drejtorise kane permiresuar higjienen e ambientit te guzhines.

Paragrafi 127

Mungesa e medikamenteve psikotropeve

Per vitin 2001 Drejtoria Ekonomike ne Ministrine e Shendetesise ka akorduar nje fond shtese me qellim blerjen e medikamenteve, ne sasi dhe sipas listes se kerkuar nga Drejtoria e Spitaleve, duke plotesuar ne masen 90% nevojat per medikamente psikotrope. Problem kryesor eshte kryerja e

aktiviteteve te rehabilitimit. Pervec organizimit te aktiviteteve sportive po punohet per hapjen e nje atelie ergoterapie.

Paragrafi 133

Personeli infermier te perfitoje nje formim special fillestar e te vazhdueshem ne psikiatri.

Ministria e Shendetesise ne bashkepunim me Departamentin e Psikiatrize ne Qendren Spitalore Universitare ne Tirane, ka pergatitur dhe miratuar rregulloren e funksionimit te sherbimit psikiatrik ne institucionet me shtreter. Ne kete rregullore nje pjese e rendesishme i kushtohet detyrimeve qe kane drejtuesit e institucionit qe ne baze te nje plani te percaktuar dhe ne menyre sistematike e te vazhdueshme te bejne kualifikimin e personelit infermier dhe atij ndihmes.

Ne kete rregullore jane percaktuar ne menyre te qarte detyrat dhe kompetencat e personelit infermier e atij ndihmes, duke pasur per baze Karten e te Drejtave te Pacientit.

Paragrafi 135

Mbi funksionimin e dhomave te izolimit.

Ministria e Shendetesise nepermjet nje Urdherese ka porositur drejtuesit e ketyre spitaleve qe mjetet e shtrengimit dhe dhenia e sedativeve, te perdoren sa me rralle te jete e mundur dhe gjithmone me autorizim te shefit te sherbimit.

Se fundi theksojme se te dy materialet (ai i dhjetorit 2000 dhe i nentorit 2001) e derguara nga CPT, te perkthyer ne shqip dhe ne origjinal

(frenghisht), i jane derguar te gjitha institucioneve shendetesore qe trajtojne te semure psiqike.

PERGJIGJA E MINISTRISE SE MBROJTJES

Ne lidhje me gjendjen e njesise 1100 te Policise Ushtarake Shkoder, konstatohet se:

Ngjarjet e vitit 1997 ne vendin tone, pamundesia per investime ne fazen e ristrukturimit te forcave te armatosura, perberjeme disa nga shkaqet objektive te gjendjes se konstatuar nga **CPT** ne njesine 1100 te Policise Ushtarake, Shkoder.

Nga ana e ketij autoritetit kane qene dhe mbeten ne qender te vemendjes respektimi i te drejtave dhe lirive te njeriut dhe ne kete kuader jane marre vazhdimisht masa parandaluese per te evituar raste te perdorimit te torturave. Ne kete kendveshtrim ne njesine 1100 te Policise Ushtarake Shkoder, jane marre masa per vendosjen e kushteve te mira ne dhomat e ndalimit dhe paisjen e tyre sipas kerkesave te ligjit. Per vitin ne vazhdim do te behen permiresime te reja ne drejtim te kompletimit te ambienteve sipas standarteve te kerkuara per kete njesi.

Gjithashtu rendesi i kemi kushtuar kualifikimit te personelit qe sherben ne kete post Policie Ushtarake.

Eshte programuar te behen permiresimet e duhura ligjore per Kodin Penal Ushtarak dhe Ligjin "Per Policine Ushtarake", ne kuadrin e perafrimit te legjislacionit shqiptar me ate te Bashkimit Evropian.